



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-05  
**Prokurori kundër Salih Mustafës**

**Vendosi:** Gjykatësi i Procedurës Paraprake  
Gjykatës Nikola Giju

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Data:** 30 prill 2021

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Version i redaktuar publik i  
Vendimit të dytë mbi pjesëmarrjen e viktimave**

---

**Prokurorit të Specializuar**  
Xhek Smith

**Mbrojtësit të të Akuzuarit**  
Julius von Bone

**Zyrës Administrative**  
Zyrës së Pjesëmarrjes së Viktimave

I.	HISTORIKU PROCEDURAL .....	2
II.	PARASHTRIMET .....	3
III.	DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE .....	4
	A. Parashtrimi i kërkesës dhe pranimi në proces .....	4
	B. Pjesëmarrja në procedurën paraprake .....	5
	C. Masat mbrojtëse .....	6
IV.	DISKUTIM .....	7
	A. Plotësia e kërkesave .....	7
	B. Pranueshmëria e kërkesave .....	7
	(a) Personi fizik .....	8
	(b) Krimet e pretenduara .....	9
	(c) Dëmi i pësuar personalisht si rezultat i drejtpërdrejtë i një krimi të përfshirë në aktakuzë .....	9
	(d) Përfundim .....	13
	C. Masat Mbrojtëse .....	13
	(a) Formularët e kërkesës.....	14
	(b) Identiteti i parashtruesve të kërkesave .....	14
	D. Grupimi dhe përfaqësimi ligjor i përbashkët.....	16
	E. Pjesëmarrja në procedurën paraprake .....	18
V.	VENDIM .....	19

**GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE**,<sup>1</sup> në pajtim me nenet 22, 39(1), (11) dhe (13) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullat 80, 95(2)(h)-(i), 113 dhe 114 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon vendimin e mëposhtëm.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më datë 12 qershor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi aktakuzën kundër Salih Mustafës ("z. Mustafa" ose "i akuzuari").<sup>2</sup> Më datë 19 qershor 2020, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") parashtroi aktakuzën e konfirmuar ("Aktakuza e Konfirmuar").<sup>3</sup>

2. Më datë 27 nëntor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori një vendim kornizë mbi parashtrimin e kërkesave nga viktimat ("Vendimi Kornizë"), ku, ndër të tjera, urdhëroi Zyrën e Pjesëmarrjes së Viktimave ("ZPV") që brenda datës 10 dhjetor 2020 t'u paraqiste raportin e parë në pajtim me rregullën 113(2) të Rregullores, Gjykatësit të Procedurës Paraprake dhe palëve lidhur me kërkesat e dorëzuara dhe të paraqiste periodikisht raporte të mëtejshme, nëse do të kishte, jo më vonë se dorëzimi i parashtrimit të Mbrojtjes sipas rregullës 95(5) të Rregullores.<sup>4</sup>

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-05, F00001, Kryetarja, *Vendim për caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 14 shkurt 2020, publik.

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-05, F00008, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi konfirmimin e aktakuzës kundër Salih Mustafës*, 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar publik u protokollua më 5 tetor 2020, F00008/RED.

<sup>3</sup> KSC-BC-2020-05, F00011/A02, Prokurori i Specializuar, *Aktakuzë*, 19 qershor 2020, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik i Aktakuzës së Konfirmuar u protokollua më 28 shtator 2020: KSC-BC-2020-05, F00019/A01, Prokurori i Specializuar, *Version i redaktuar publik i Aktakuzës*, 19 qershor 2020, publik.

<sup>4</sup> KSC-BC-2020-05, F00055, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim kornizë mbi parashtrimin e kërkesave nga viktimat*, 27 nëntor 2020, publik, para. 55(c)-(e).

3. Më datë 9 dhjetor 2020, ZPV-ja paraqiti raportin e saj të parë mbi kërkesat e ardhura (“raporti i parë”).<sup>5</sup>
4. Më datë 10 shkurt 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori “Vendimin e parë mbi pjesëmarrjen e viktimave”.<sup>6</sup>
5. Më datë 1 prill 2021, ZPV-ja paraqiti raportin e saj të dytë mbi kërkesat e ardhura (“raporti i dytë”) me gjashtë shtojca rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, të cilat përmbanin një tabelë me numrin dhe të dhënat e parashtruesve të kërkesave për të cilët rekomandohej pranimi, si dhe përmbledhjet e kërkesave të përpiluara nga ZPV-ja.<sup>7</sup>
6. Mbrojtja e z. Mustafës dhe ZPS-ja nuk paraqitën vërejtje në lidhje me raportin e dytë.

## II. PARASHTRIMET

7. ZPV-ja parashtron se, që nga paraqitja e raportit të parë të saj, ka marrë pesë kërkesa nga persona që kërkojnë pranimin në proces si viktima pjesëmarrëse, të cilat u parashtruan me ndihmën e drejtpërdrejtë të ZPV-së.<sup>8</sup> ZPV-ja rekomandon që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të miratojë të pesë kërkesat.<sup>9</sup> ZPV-ja gjithashtu rekomandon që të dhënat identifikuese të të gjithë parashtruesve të kërkesave të mos u bëhen të ditura publikut, Mbrojtjes dhe të akuzuarit.<sup>10</sup>

---

<sup>5</sup> KSC-BC-2020-05, F00062, Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave, *Raporti i parë i Zyrës Administrative drejtuar Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi kërkesat e viktimave për pjesëmarrje në proces*, 9 dhjetor 2020, publik, me shtojcat rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* 1-4.

<sup>6</sup> KSC-BC-2020-05, F00075, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim i parë mbi pjesëmarrjen e viktimave*, 10 shkurt 2021, publik.

<sup>7</sup> KSC-BC-2020-05, F00099, Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave, *Raporti i dytë i Zyrës Administrative drejtuar Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi kërkesat e viktimave për pjesëmarrje në proces*, 1 prill 2021, konfidencial, me shtojcat konfidenciale dhe *ex parte* 1-6. Versioni i redaktuar publik i Raportit të Dytë u protokollua më 9 prill 2021, F00099/RED.

<sup>8</sup> Raporti i Dytë, para. 7.

<sup>9</sup> Raporti i Dytë, para. 11-27.

<sup>10</sup> Raporti i Dytë, para. 45-53.

### III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

#### A. PARASHTRIMI I KËRKESËS DHE PRANIMI NË PROCES

8. Në pajtim me nenin 22(1) të Ligjit dhe rregullën 2 të Rregullores, viktimë është personi fizik që ka pësuar personalisht dëm fizik, mendor apo material si pasojë e drejtpërdrejtë e një vepre penale që bie brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara dhe që pretendohet në një aktakuzë të konfirmuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.

9. Në pajtim me rregullën 113(1) të Rregullores, pas konfirmimit të një aktakuze dhe në kohë të mjaftueshme përpara hapjes së çështjes, një person që pretendon se është viktimë e një vepre penale të pretenduar në aktakuzë, mund të bëjë kërkesë për pranim si viktimë pjesëmarrëse në proces ("VPP"), në të cilën saktëson se si i përmbush kriteret si viktimë dhe jep vendin dhe datën e veprës penale që pretendohet se ka shkaktuar dëm. Formularët e kërkesave nuk u bëhen të njohura palëve.

10. Në pajtim me rregullën 113(2) të Rregullores, ZPV-ja regjistron dhe vlerëson kërkesat dhe ia dorëzon Gjykatësit të Procedurës Paraprake, së bashku me një rekomandim për pranueshmërinë dhe përfaqësimin e përbashkët, si dhe një kërkesë për masa mbrojtëse sipas rregullës 80 të Rregullores, sipas rastit. ZPV-ja gjithashtu duhet t'u parashtrorë palëve një raport konfidencial, pa zbuluar të dhënat identifikuese të parashtruesve të kërkesave.

11. Në pajtim me rregullën 113(3) të Rregullores, palët mund të bëjnë parashtrime vetëm në lidhje me aspektin ligjor të pranueshmërisë dhe përfaqësimit të përbashkët.

12. Në pajtim me rregullat 95(2)(i) dhe 113(4)-(5) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka dhënë prova *prima facie* për dëmin e pësuar si rezultat i drejtpërdrejtë i një vepre penale të përfshirë në aktakuzë dhe nxjerr një vendim të arsyetuar me anë të të cilit miraton ose refuzon pranimin në proces. Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu vendos në lidhje me

përfaqësimin e përbashkët dhe çfarëdo kërkesë për masa mbrojtëse. Vendimi u njoftohet parashtruesit të kërkesës, ZPV-së dhe palëve.

13. Në pajtim me rregullën 113(6) të Rregullores, personat të cilëve u refuzohet kërkesa kanë të drejtën e apelimit të vendimit brenda katërmbëdhjetë (14) ditësh nga njoftimi i vendimit.

14. Në pajtim me rregullën 113(8) të Rregullores, pasi konsultohet me ZPV-në, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vendos nëse VPP-të të ndahen në grupe me përfaqësim të përbashkët, duke marrë parasysh: a) konfliktet e interesave që mund të pengojnë përfaqësimin e përbashkët; (b) interesat e ngjashme që mund të lehtësojnë përfaqësimin e përbashkët; dhe (c) të drejtat e të akuzuarit dhe interesat e një gjykimi të drejtë dhe të shpejtë.

#### B. PJESËMARRJA NË PROCEDURËN PARAPRAKE

15. Në pajtim me nenin 22(3) të Ligjit, interesi personal dhe të drejtat e një VPP-je në procedurën penale para Dhomave të Specializuara janë njoftimi, pranimi dhe zhdëmtimi.

16. Në pajtim me rregullën 113(7) të Rregullores, kur viktimave u miratohet e drejta e pjesëmarrjes në proces, grupit të VPP-ve Administratori i cakton një mbrojtës të viktimave, në përputhje me Direktivën për Mbrojtësit.

17. Në pajtim me nenin 22(6) të Ligjit dhe rregullën 114(1) të Rregullores, VPP-të i ushtrojnë të drejtat e tyre përmes mbrojtësit të viktimave që u caktohet, ndër të tjera edhe gjatë procedurës paraprake, kur preken interesat personale të tyre dhe vetëm kur kjo nuk cenon ose nuk bie ndesh me të drejtat e të akuzuarit.

18. Në pajtim me rregullën 114(4) të Rregullores, nëse është e nevojshme dhe varësisht nga rrethanat, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxjerr udhëzime të posaçme

që rregullojnë pjesëmarrjen e VPP-ve në procedurën paraprake, në përputhje me nenin 22(3) dhe (6) të Ligjit.

19. Në pajtim me rregullën 114(2) të Rregullores, mbrojtësi i viktimave mund të jetë i pranishëm në procedurën paraprake nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake e çmon të arsyeshme, me qëllim garantimin e interesave personale dhe të drejtave të VPP-ve, në përputhje me nenin 22(3) të Ligjit.

20. Në pajtim me rregullën 114(3) të Rregullores, mbrojtësi i viktimave ka qasje në materiale konfidenciale, përveç nëse Rregullorja parashikon ndryshe, ose sipas vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake. Mbrojtësi i viktimave i informon rregullisht klientët për zhvillimet përkatëse në lidhje me çështjen gjyqësore, në një mënyrë që nuk zbulon informacione konfidenciale.

21. Në pajtim me rregullën 114(4) të Rregullores, kurdoherë që preken interesat personale të VPP-ve dhe nëse Rregullorja nuk parashikon ndryshe, mbrojtësi i viktimave, nën mbikëqyrjen e Gjykatësit të Procedurës Paraprake, mund të bëjë parashtrime me gojë dhe me shkrim.

#### C. MASAT MBROJTËSE

22. Në pajtim me nenin 39(11) të Ligjit dhe rregullën 95(2)(h) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, kur është e nevojshme, mund të marrë vendime mbi mocionet në lidhje me mbrojtjen dhe privatësinë e viktimave dhe dëshmitarëve, të parashtruara përpara kalimit të dosjes së çështjes gjyqësore.

23. Në pajtim me rregullën 80(1) të Rregullores, një panel, *proprio motu* ose me kërkesë të një pale, mund të urdhërojë masa mbrojtëse për mbrojtjen, sigurinë, mirëqenien fizike dhe mendore, dinjitetin dhe privatësinë, ndër të tjera, të viktimave pjesëmarrëse në procese.

24. Në pajtim me rregullën 80(4) të Rregullores, masa të tilla mund të përfshijnë mosnxjerrjen për palët të materialit apo informacionit që mund të çojë në zbulimin e identitetit të dëshmitarit apo viktimës pjesëmarrëse në procesin gjyqësor.

#### IV. DISKUTIM

##### A. PLOTËSIA E KËRKESAVE

25. ZPV-ja parashtron se të pesë kërkesat e parashtruara mund të konsiderohen formalisht të plota në përputhje me kriteret e përcaktuara në vendimin kornizë.<sup>11</sup>

26. Pas shqyrtimit të formularëve të kërkesave, përmbledhjeve të kërkesave dhe dokumentacionit mbështetës sipas kriterëve të përcaktuara në vendimin kornizë,<sup>12</sup> Gjykatësi i Procedurës Paraprake është bindur se të pesë kërkesat përmbajnë dëshmi identiteti të mjaftueshme dhe të dhënat personale, bëjnë të ditur me qartësi të mjaftueshme datën/periudhën dhe vendndodhjen e krimeve si edhe dëmin e pësuar, dhe kanë nënshkrimin e vlefshëm. Në lidhje me viktimat 05/05 dhe 06/05, janë paraqitur edhe dëshmi të mjaftueshme të lidhjes familjare. Megjithëse asnjëra nga viktimat nuk ka dorëzuar dokumentacion për dëmin e pësuar, përshkrimi i hollësishëm i bërë nga parashtruesit e kërkesave sa u takon ngjarjeve dhe dëmit të pësuar ka qenë i mjaftueshëm për të arritur në konstatimet përkatëse. Bazuar në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se të pesë kërkesat janë të plota.

##### B. PRANUESHMËRIA E KËRKESAVE

27. ZPV-ja rekomandon që Gjykatësi i Procedurës Paraprake t'i pranojë të pesë parashtruesit e kërkesave si viktimat pjesëmarrëse (Grupi A),<sup>13</sup> dhe parashtron se: (i) të pesë parashtruesit e kërkesave janë persona fizikë;<sup>14</sup> (ii) të gjitha krimet e

---

<sup>11</sup> Raporti i Dytë, para. 12.

<sup>12</sup> Vendimi Kornizë, para. 22.

<sup>13</sup> Raporti i Dytë, para. 27.

<sup>14</sup> Raporti i Dytë, para. 15.



pretenduara në kërkesat janë krime të përfshira në Aktakuzën e Konfirmuar që bien brenda kuadrit kohor dhe gjeografik të saj;<sup>15</sup> (iii) dëmi i pësuar nga parashtruesit e kërkesave si viktimat të drejtpërdrejta ose të tërthorta është përshkruar me hollësi të mjaftueshme;<sup>16</sup> dhe (iv) ekziston lidhja shkak-pasojë midis dëmit të pësuar nga parashtruesit e kërkesave dhe krimeve të përfshira në Aktakuzën e Konfirmuar mbi bazë *prima facie*.<sup>17</sup>

28. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se vlerësimi i kërkesave sipas kriterëve të pranueshmërisë të përcaktuara në vendimin kornizë<sup>18</sup> bëhet mbi bazë *prima facie*, duke mbajtur parasysh koherencën e brendshme të kërkesës në tërësi, përfshirë dokumentacionin mbështetës, dhe të gjitha rrethanat përkatëse.<sup>19</sup> Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk bën vlerësim material të besueshmërisë apo saktësisë së informacionit dhe provave të paraqitura.<sup>20</sup> Gjithsesi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk mbështetet në informacione apo materiale mbështetëse të cilat janë qartësisht joautentike.<sup>21</sup>

(a) Personi fizik

29. Gjykatësi i Procedurës Paraprake është bindur se të pesë parashtruesit e kërkesave janë persona fizikë.

<sup>15</sup> Raporti i Dytë, para. 16-18.

<sup>16</sup> Raporti i Dytë, para. 19-23.

<sup>17</sup> Raporti i Dytë, para. 24.

<sup>18</sup> Vendimi Kornizë, para. 27.

<sup>19</sup> Vendimi Kornizë, para. 28.

<sup>20</sup> *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-06, F00257/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i redaktuar publik i vendimit të parë mbi pjesëmarrjen e viktimave* ("Thaçi dhe të tjerët, Vendim i parë mbi pjesëmarrjen e viktimave"), 21 prill 2021, publik, para. 43. *Ngjashëm*, ICC/GJPN, *Prosecutor v. Lubanga*, ICC-01/04-01/06-1119, Trial Chamber I, [Decision on Victims' Participation](#) ("Lubanga Decision on Victim Participation"), 18 janar 2008, para. 99; *Prosecutor v. Bemba*, ICC-01/05-01/08-1862, Trial Chamber III, [Decision on 270 Applications by Victims to Participate in the Proceedings](#), 25 tetor 2011, para. 27.

<sup>21</sup> *Thaçi dhe të tjerët*, Vendim i parë mbi pjesëmarrjen e viktimave, para. 43. *Ngjashëm*, KSC-BC-2020-06, F00026/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i redaktuar publik i vendimit për konfirmimin e aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, 26 tetor 2020, para. 50.

(b) Krimet e pretenduara

30. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se “krimi” në lidhje me të cilin një parashtrues kërkesë pretendon se është viktimë, duhet të jetë brenda parametrave materialë, gjeografikë dhe kohorë të akuzave të paraqitura në Aktakuzën e Konfirmuar.<sup>22</sup> Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu rikujton se parashtruesi i kërkesës duhet të përshkruajë, sa më konkretisht, vendin dhe kohën e ngjarjes dhe, nëse është e mundur, çdo kryes të pretenduar të pranishëm në vendin e ngjarjes apo të përfshirë në ngjarje.<sup>23</sup>

31. Bazuar në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se të pesë parashtruesit e kërkesave janë viktima të një krimi bazë të pretenduar në Aktakuzën e Konfirmuar, sikurse parashihet në rregullat 2 dhe 113(1) të Rregullores. Konkretisht, viktimat 05/05 dhe 06/05 janë viktima të krimeve [REDAKTUAR] në kompleksin e ndalimit në Zllash, ndërsa viktimat 07/05, 08/05, dhe 09/05 janë viktima të krimeve që pretendohet se janë kryer në të njëjtën vendndodhje.<sup>24</sup> Së fundi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se krimet e përshkruara nga pesë parashtruesit e kërkesave bien brenda periudhës kohore të përcaktuar në Aktakuzën e Konfirmuar.

(c) Dëmi i pësuar personalisht si rezultat i drejtpërdrejtë i një krimi të përfshirë në aktakuzë

32. Në lidhje me dëmin e pësuar personalisht nga viktima, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rithekson konstatimin e tij në vendimin kornizë se dëmin duhet ta ketë pësuar *vetë* parashtruesi i kërkesës, *d.m.th.* duhet të jetë cenuar mirëqenia fizike ose psikologjike, ose gjendja ekonomike e vetë parashtruesit të kërkesës. Kjo mund të

---

<sup>22</sup> Vendimi Kornizë, para. 31; *Thaçi dhe të tjerët*, Vendim i parë mbi pjesëmarrjen e viktimave, para. 45.

<sup>23</sup> Vendimi Kornizë, para. 31.

<sup>24</sup> Aktakuza e Konfirmuar, para. 35.

përfshijë dëmin e pësuar nga viktimat që kanë qenë objekt i veprimeve të kryesit ose kryesve (“viktimat e drejtpërdrejta”), ose të pësuar nga individë me lidhje të afërta personale me viktimën e drejtpërdrejtë të vrarë ose të lënduar nga kryesi ose kryesit (“viktimat e tërthorta”).<sup>25</sup> Në këtë kontekst, Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson gjithashtu se familjarët e afërt (bashkëshorti, bashkëshortja, prindërit, fëmijët, vëllezërit, motrat) nënkuptohet se kanë lidhje të ngushtë me viktimën e drejtpërdrejtë,<sup>26</sup> por se edhe anëtarë të tjerë të familjes të cilët kanë një lidhje veçanërisht të afërt ose lidhje vartësie me viktimën e drejtpërdrejtë, mund të konsiderohen se kanë lidhje të ngushtë me të.<sup>27</sup> Afërsia e lidhjes që kërkohet nuk varet nga ajo nëse viktima e drejtpërdrejtë është vrarë apo ka pësuar lëndim.<sup>28</sup>

33. Sa i përket llojit të dëmit të pësuar nga viktimat e krimeve, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se në Ligj dhe Rregullore përcaktohen tre lloje dëmi: fizik, mendor dhe material.<sup>29</sup>

34. Dëmi fizik nënkupton çdo lloj lëndimi trupor, si plagë, thyerje, shfytërim, gjymtim, humbje ose mosfunksionim të organeve, dëmtim trupor, sëmundje të lehtë

<sup>25</sup> Vendimi Kornizë, para. 33.

<sup>26</sup> *Thaçi dhe të tjerët*, Vendim i parë mbi pjesëmarrjen e viktimave, para. 50; [United Nations Basic Principles on the Right to a Remedy and Reparation for Victims of Gross Violations of International Human Rights Law and Serious Violations of International Humanitarian Law](#) (“UN Basic Principles”), UNGA Resolution 60/147, 16 dhjetor 2005, A/RES/60/147, para. 8: termi “viktimë” përfshin familjarët e afërt ose persona në varësi financiare të viktimës së drejtpërdrejtë.

<sup>27</sup> *Thaçi dhe të tjerët*, Vendim i parë mbi pjesëmarrjen e viktimave, para. 50. *Ngjashëm*, ICC/GJPN, [Lubanga Appeal Decision on Victim Participation](#), para. 32; *Prosecutor v. Lubanga*, ICC-01/04-01/06-1813, Trial Chamber I, [Redacted Version of “Decision on ‘Indirect Victims’”](#), 8 prill 2009, para. 44, 50; STL/TSL, *Prosecutor v. Ayyash et al.*, STL-11-01/PT, Pre-Trial Judge, [Decision on Victims’ Participation in the Proceedings](#) (“*Ayyash et al.* Decision on Victim Participation”), 8 maj 2012, para. 49; *Prosecutor v. Ayyash*, STI-18-10/PT, Pre-Trial Judge, [Decision Relating to Victims’ Participation in the Proceedings and Their Legal Representation](#) (“2020 *Ayyash* Decision on Victim Participation”), 17 prill 2020, para. 26.

<sup>28</sup> *Thaçi dhe të tjerët*, Vendim i parë mbi pjesëmarrjen e viktimave, para. 50. *Ngjashëm*, STL/TSL, [Ayyash et al. Decision on Victim Participation](#), para. 50; [2020 Ayyash Decision on Victim Participation](#), para. 26.

<sup>29</sup> Neni 22(1) i Ligjit; rregulla 2 e Rregullores. *Shih gjithashtu UN Basic Principles*, para. 8, ku thuhet se dëmi mund të përfshijë lëndimin fizik ose mendor, vuajtjen emocionale, humbjen ekonomike ose cenimin material të drejtave themelore. *Ngjashëm*, ICC/GJPN, [Lubanga Appeal Decision on Victim Participation](#), para. 31-32; STL, [Ayyash et al. Decision on Victim Participation](#), para. 63-84.

apo të rëndë, ose vdekje.<sup>30</sup> Lëndimi trupor nuk ka nevojë të jetë i rrezikshëm për jetën apo i përhershëm, por duhet të jetë i natyrës ose ashpërsisë që ndikon në shëndetin ose mirëqenien e viktimës.<sup>31</sup> Krahas kësaj, viktimat e tërthorta duhet të dëshmojnë se dëmi fizik që kanë pësuar është rezultat i dëmit të pësuar nga viktima e drejtpërdrejtë. Kjo mund të ndodhë kur vuajtja e rëndë ose e vazhdueshme emocionale e viktimës së tërthortë për shkak të vdekjes së viktimës së drejtpërdrejtë apo të dëmit të pësuar nga viktima e drejtpërdrejtë, shkakton sëmundje ose lëngim.<sup>32</sup>

35. Dëmi mendor nënkupton çdo lloj vuajtjeje psikologjike, si dhembje, pikëllim i thellë, çrregullim i stresit pastraumatik, ose lloje të tjera të çrregullimeve psikologjike, traumave ose stresit emocional.<sup>33</sup> Vuajtja psikologjike duhet të jetë e një shkalle të caktuar rëndese; shqetësimi emocional kalimtar në vetvete nuk cilësohet si dëm mendor.<sup>34</sup> Krahas kësaj, viktimat e tërthorta duhet të dëshmojnë se dëmi mendor që kanë pësuar është rezultat i dëmit të pësuar nga viktima e drejtpërdrejtë. Gjithsesi, vuajtja emocionale (si dhembja, hidhërimi, pikëllimi i thellë, ose shqetësimi) e një viktime të tërthortë si rezultat i vdekjes ose lëndimit të rëndë të një viktime të drejtpërdrejtë mund të nënkuptohet, me kusht që të konstatohet në masë të mjaftueshme lidhja e ngushtë midis tyre.<sup>35</sup>

---

<sup>30</sup> *Thaçi dhe të tjerët*, Vendim i parë mbi pjesëmarrjen e viktimave, para. 52. *Ngjashëm*, ECCC/DHJGJK, *Co-Prosecutors v. Kaing*, Case 001, Supreme Court Chamber, [Appeal Judgment](#) (“*Duch Appeal Judgment*”), 3 shkurt 2012, para. 415. *Shih gjithashtu*, ICC/GJPN, *Prosecutor v. Bemba*, ICC-01/05-01/08-320, Pre-Trial Chamber III, [Fourth Decision on Victims’ Participation](#) (“*Bemba 4<sup>th</sup> Decision on Victim Participation*”), 12 dhjetor 2008, para. 70.

<sup>31</sup> *Thaçi dhe të tjerët*, Vendim i parë mbi pjesëmarrjen e viktimave, para. 52 *Ngjashëm*, STL/TSL, [Ayyash et al. Decision on Victim Participation](#), para. 65.

<sup>32</sup> *Thaçi dhe të tjerët*, Vendim i parë mbi pjesëmarrjen e viktimave, para. 52. *Ngjashëm*, ECCC/DHJGJK, [Duch Appeal Judgment](#), para. 417.

<sup>33</sup> *Thaçi dhe të tjerët*, Vendim i parë mbi pjesëmarrjen e viktimave, para. 53. *Ngjashëm*, ECCC/DHJGJK, [Duch Appeal Judgment](#), para. 415; STL/TSL, [Ayyash et al. Decision on Victim Participation](#), para. 77. *Shih gjithashtu* ICC/GJPN, [Bemba 4<sup>th</sup> Decision on Victim Participation](#), para. 70.

<sup>34</sup> *Thaçi dhe të tjerët*, Vendim i parë mbi pjesëmarrjen e viktimave, para. 53. *Ngjashëm*, STL/TSL, [2020 Ayyash Decision on Victim Participation](#), para. 41.

<sup>35</sup> *Thaçi dhe të tjerët*, Vendim i parë mbi pjesëmarrjen e viktimave, para. 53. *Ngjashëm*, ICC/GJPN, [Lubanga Appeal Decision on Victim Participation](#), para. 32; *Prosecutor v. Ruto et al.*, ICC-01/09-01/11-249, Pre-

36. Dëmi material nënkupton çdo lloj dëmtimi ose humbjeje pronësore ose financiare, si shkatërrimi, dëmtimi ose vjedhja e pronës vetjake, humbja e të ardhurave ose mjeteve të jetesës, ose forma të tjera të humbjeve ekonomike.<sup>36</sup> Dëmtimi ose humbja pronësore ose financiare duhet të ketë një ndikim të qenësishëm në mjetet e jetesës së viktimës. Krahas kësaj, viktimat e tërthorta duhet të dëshmojnë se dëmi material që kanë pësuar është rezultat i dëmit të pësuar nga viktima e drejtpërdrejtë. Kjo mund të ndodhë kur vdekja e viktimës së drejtpërdrejtë apo dëmi i pësuar nga viktima e drejtpërdrejtë ka shkaktuar humbjen e të ardhurave për viktimën e tërthortë.<sup>37</sup>

37. Në lidhje me kriterin që dëmi duhet të jetë rezultat i drejtpërdrejtë i një krimi të përfshirë në Aktakuzën e Konfirmuar, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rithekson konstatimin e tij në vendimin kornizë se dëmi është rezultat i drejtpërdrejtë i krimit kur, në rrethanat që mbizotëronin në vendin dhe kohën përkatëse dhe duke marrë parasysh rrethanat personale të viktimës, sipas një vëzhguesi objektiv ka shumë të ngjarë që veprimet ose mosveprimet e kryesit ose kryesve do ta shkaktinin këtë dëm.<sup>38</sup> Nuk është e domosdoshme që krimi të jetë i vetmi shkak i dëmit të pësuar, por duhet që të ketë kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në shkaktimin e dëmit.<sup>39</sup> Në veçanti, në lidhje me dëmin fizik ose mendor, parashtruesit e kërkesave që janë viktima të drejtpërdrejta së paku duhet të tregojnë se ishin të pranishëm në vendin e ngjarjes në kohën përkatëse dhe se ishin objekt i veprimeve ose mosveprimeve të kryesit ose kryesve. Pavarësisht nga lloji i dëmit, parashtruesit e kërkesave që janë viktima të tërthorta duhet të dëshmojnë të paktën se dëmi që kanë pësuar ka qenë

---

Trial Chamber II, [Decision on Victims' Participation at the Confirmation of Charges Hearing and in the Related Proceedings](#), 5 gusht 2011, para. 55; STL/TSL, [2020 Ayyash Decision on Victim Participation](#), para. 44.

<sup>36</sup> *Thaçi dhe të tjerët*, Vendim i parë mbi pjesëmarrjen e viktimave, para. 54. *Ngjashëm*, ECCC/DHJGJK, [Duch Appeal Judgment](#), para. 415; STL/TSL, [Ayyash et al. Decision on Victim Participation](#), para. 72; [2020 Ayyash Decision on Victim Participation](#), para. 37. *Shih gjithashtu*, [Bemba 4<sup>th</sup> Decision on Victim Participation](#), para. 70.

<sup>37</sup> *Thaçi dhe të tjerët*, Vendim i parë mbi pjesëmarrjen e viktimave, para. 54. *Ngjashëm*, ECCC/DHJGJK, [Duch Appeal Judgment](#), para. 417.

<sup>38</sup> Vendimi Kornizë, para. 38.

<sup>39</sup> *Thaçi dhe të tjerët*, Vendim i parë mbi pjesëmarrjen e viktimave, para. 55. *Ngjashëm*, ICC/GJPN, [Bemba 4<sup>th</sup> Decision on Victim Participation](#), para. 77.

pasojë e dëmit të pësuar nga viktimat e drejtpërdrejtë me të cilën kishin lidhje të ngushtë personale.<sup>40</sup>

38. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rrjedhimisht konstaton se: (i) viktimat 08/05 dhe 09/05 kanë pësuar dëm fizik, si prerje, mavijosje dhe thyerje dhëmbësh; dhe se (ii) viktimat 07/05, 08/05 dhe 09/05 kanë pësuar dëm mendor, si ankth dhe çrregullim të stresit pastraumatik me pasoja të përhershme, si rezultat i drejtpërdrejtë i ndalimit të pretenduar të tyre në kompleksin e ndalimit në Zllash dhe keqtrajtimit fizik dhe/ose psikologjik që pësuan gjatë kohës që u mbajtën të ndaluar atje. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se viktimat 05/05 dhe 06/05, [REDAKTUAR], kanë pësuar dëm mendor, si pikëllim të thellë dhe traumë të rëndë, si rezultat i krimeve që pretendohet se janë kryer [REDAKTUAR].

#### (d) Përfundim

39. Bazuar në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se ekzistojnë prova *prima facie* se viktimat 05/05, 06/05, 07/05, 08/05, dhe 09/05 kanë pësuar dëm si rezultat i drejtpërdrejtë i një krimi të pretenduar në Aktakuzën e Konfirmuar. Rrjedhimisht, këta parashtrues kërkesë pranohen në proces si viktimat pjesëmarrëse.

#### C. MASAT MBROJTËSE

40. ZPV-ja parashtron se: (i) viktimat 07/05 kërkon që të dhënat identifikuese të mos i bëhen të ditura publikut; (ii) viktimat 05/05 dhe 06/05 kërkojnë që të dhënat identifikuese të mos u bëhen të ditura publikut dhe të akuzuarit; dhe (iii) viktimat 08/05 dhe 09/05 kërkojnë që të dhënat identifikuese të mos u bëhen të ditura publikut, të akuzuarit dhe mbrojtësit të specializuar.<sup>41</sup> ZPV-ja gjithashtu parashtron se

---

<sup>40</sup> *Thaçi dhe të tjerët*, Vendim i parë mbi pjesëmarrjen e viktimave, para. 55. *Ngjashëm*, STL/TSL, [2020 Ayyash Decision on Victim Participation](#), para. 27.

<sup>41</sup> Raporti i Dytë, para. 44.

shqetësimet lidhur me një atmosferë të rrezikshme të frikësimit të viktimave në Kosovë dhe fakti që Kosova është një vend i vogël, ku njerëzit jetojnë në komunitete të lidhura ngushtë dhe ku i akuzuari ka ndikim dhe burime të mëdha, ndikojnë te të gjitha viktimat që kërkojnë pjesëmarrje.<sup>42</sup> Në bazë të kësaj, ZPV-ja parashtron se ekzistojnë rreziqe objektivisht të arsyetueshme për të gjithë parashtruesit e kërkesave, pa pasur nevojë që ata të përmendin kërcënimet konkrete kundër tyre ose familjeve të tyre.<sup>43</sup> Rrjedhimisht, nxjerrja e të dhënave identifikuese të tyre do të përbënte rrezik për sigurinë e parashtruesve të kërkesave dhe të anëtarëve të familjeve të tyre.<sup>44</sup> Për këtë arsye, ZPV-ja rekomandon që të dhënat identifikuese të të gjithë parashtruesve të kërkesave të mos i bëhen të ditura publikut dhe që të gjithë parashtruesve të kërkesave t'u jepet anonimitet përballë mbrojtësit dhe të akuzuarit.<sup>45</sup>

(a) Formularët e kërkesës

41. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton që në fillim se rregulla 113(1) e Rregullores përcakton shprehimisht se formularët e kërkesave nuk u bëhen të njohura palëve. Për këtë arsye, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se të gjithë formularët e kërkesave, përmbledhjet e kërkesave dhe dokumentacioni mbështetës duhet të vazhdojnë të mbajnë klasifikimin rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

(b) Identiteti i parashtruesve të kërkesave

42. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje që në fillim se, sikurse theksohet në vendimin kornizë, kriteret ligjore që zbatohen për masat mbrojtëse në lidhje me dëshmitarët janë të zbatueshme edhe në lidhje me VPP-të.<sup>46</sup> Krahas kësaj, gjatë

---

<sup>42</sup> Raporti i Dytë, para. 46.

<sup>43</sup> Raporti i Dytë, para. 47.

<sup>44</sup> Raporti i Dytë, para. 47.

<sup>45</sup> Raporti i Dytë, para. 48-49.

<sup>46</sup> Vendimi Kornizë, para. 46.

përcaktimit të masave të përshtatshme mbrojtëse në lidhje me VPP-të, Gjykatësi i Procedurës Paraprake merr parasysh si vijon: (i) qëllimi i pjesëmarrjes së viktimave në proces është që t'u mundësojë atyre realizimin e të drejtave dhe interesave personale në përputhje me Ligjin dhe Rregulloren; dhe (ii) ky qëllim duhet mbajtur parasysh edhe gjatë shqyrtimit të masave mbrojtëse që do të urdhërohen në lidhje me VPP-të, pa cenuar masat shtesë që rrjedhin nga statusi i mundshëm i dyfishtë i tyre.<sup>47</sup> Konstatimet e mëposhtme nuk cenojnë asnjë vendim të ardhshëm të trupit gjykues përkatës në lidhje me këtë aspekt.

43. Sa i përket ekzistencës së rrezikut objektivisht të arsyetueshëm dhe domosdoshmërisë së masave mbrojtëse, Gjykatësi i Procedurës Paraprake së pari vëren se [REDAKTUAR].<sup>48</sup> [REDAKTUAR] nxjerrja e identitetit të tyre të akuzuarit dhe publikut, përbën rrezik objektivisht të arsyetueshëm për këta individë. [REDAKTUAR]. Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu mban parasysh faktorët specifik të rrezikut të zbatueshëm në lidhje me një ose më shumë nga VPP-të në çështjen aktuale, duke pasur parasysh se: (i) të gjithë vazhdojnë të vuajnë nga trauma fizike dhe/ose mendore si pasojë e keqtrajtimit që kanë pësuar ata [REDAKTUAR]; (ii) të gjithë kanë shprehur frikë ose shqetësim për sigurinë e tyre ose të anëtarëve të familjes nëse do të bëhej e ditur pjesëmarrja e tyre në proces; dhe (iii) [REDAKTUAR]. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mban parasysh se: (i) për shkak të statusit të tyre si VPP, këta individë janë veçanërisht të cenueshëm dhe masat mbrojtëse duhet të jenë të përshtatshme për nevojat e tyre të veçanta si viktima; dhe (ii) masat e përshtatshme mbrojtëse për viktimat shpesh janë mjeti juridik përmes të cilit mund të sigurohet pjesëmarrja e tyre në proces, sepse masat e tilla janë një hap i domosdoshëm për mbrojtjen e sigurisë, mirëqenies fizike dhe psikologjike, dinjitetit

---

<sup>47</sup> *Thaçi dhe të tjerët*, Vendim i parë mbi pjesëmarrjen e viktimave, para. 67.

<sup>48</sup> [REDAKTUAR].



dhe privatësisë së viktimave, në përputhje me rregullën 80 të Rregullores.<sup>49</sup> Për arsytet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vlerëson se nxjerrja për publikun dhe palët e materialeve ose informacionit që mund të çojë në zbulimin e identitetit të pesë VPP-ve, përbën një rrezik objektivisht të arsyetueshëm për këta persona dhe anëtarët e familjeve të tyre, dhe rrjedhimisht konstaton se anonimiteti i parashikuar në rregullën 80(4)(e)(i) të Rregullores është masa më e përshtatshme dhe e domosdoshme në këtë fazë të procesit.

44. Në lidhje me proporcionalitetin e këtyre masave, Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se çdo masë mbrojtëse e urdhëruar në lidhje me një viktimë pjesëmarrëse në këtë fazë nuk cenon ndryshimin e masave të tilla në një fazë të mëvonshme, përfshirë edhe nga trupi gjykues, nëse lind nevoja dhe kur të lindë kjo nevojë.<sup>50</sup> Për arsytet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se anonimiteti sipas rregullës 80(4)(e)(i) të Rregullores është një masë proporcionale në këtë fazë të procesit.

45. Në përputhje me sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron që emrat dhe të dhënat identifikuese të viktimave 05/05, 06/05, 07/05, 08/06, dhe 09/05 të mos u bëhen të ditura publikut dhe palëve, dhe referencat ndaj tyre të bëhen vetëm duke i përdorur pseudonimet e tyre.

#### D. GRUPIMI DHE PËRFAQËSIMI LIGJOR I PËRBASHKËT

46. Në lidhje me grupimin, ZPV-ja parashtron se nuk ka identifikuar asnjë problem ose dallim në kërkesat që do të kërkonte përfaqësim të veçantë dhe rekomandon që

---

<sup>49</sup> *Thaçi dhe të tjerët*, Vendim i parë mbi pjesëmarrjen e viktimave, para. 68. *Ngjashëm*, ICC/GJPN, [Lubanga Decision on Victim Participation](#), para. 128.

<sup>50</sup> *Ngjashëm*, *Thaçi dhe të tjerët*, Vendim i parë mbi pjesëmarrjen e viktimave, para. 69; ICC/GJPN, [Ongwen Decision on Victims' Identities](#), para. 12-14.

Gjykatësi i Procedurës Paraprake t'i grupojë të pesë parashtruesit e kërkesave në një grup të vetëm për qëllim të përfaqësimit të përbashkët.<sup>51</sup>

47. Sa i përket përfaqësimit të përbashkët ligjor, ZPV-ja pohon se shumica e parashtruesve të kërkesave nuk kanë shprehur ndonjë preferencë.<sup>52</sup> ZPV-ja gjithashtu përsërit edhe një herë faktorët e ndryshëm që do të marrë parasysh kur të propozojë mbrojtësin e viktimave për caktim.<sup>53</sup>

48. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rithekson konstatimin e tij në vendimin kornizë se nevoja për t'i ndarë parashtruesit e kërkesave në më shumë se një grup shtrohet kur rrethanat apo veçoritë e viktimave janë kaq të ndryshme sa që interesat e tyre janë të papajtueshme, që e bën të porealizueshëm përfaqësimin e përbashkët.<sup>54</sup> Duke marrë parasysh përkatësinë etnike, [REDAKTUAR] dhe gjuhën e VPP-ve<sup>55</sup>, si dhe faktin që të gjithë janë viktima të drejtpërdrejta ose të tërthorta të krimeve të kryera në të njëjtin vend krimi,<sup>56</sup> nga i njëjti grup kryesish, dhe kanë pësuar forma të ngjashme të dëmit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se viktimat 05/05, 06/05, 07/05, 08/05, dhe 09/05 duhet të përfaqësohen si një grup i vetëm i viktimave pjesëmarrëse në proces ("Grupi 1").

49. Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu rikujton se, në pajtim me nenin 22(5) të Ligjit dhe rregullën 113(7) të Rregullores, grupet e VPP-ve duhet të ndihmohen dhe të përfaqësohen nga mbrojtës të viktimave sapo t'u miratohet e drejta e pjesëmarrjes në proces, dhe se nuk lejohet asnjë përfaqësim tjetër për viktimat. Për këtë arsye, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e gjykon të domosdoshme të sigurojë përfaqësimin e përbashkët të VPP-ve sa më shpejt që të jetë e mundur pas nxjerrjes së këtij

---

<sup>51</sup> Raporti i Dytë, para. 39-40.

<sup>52</sup> Raporti i Dytë, para. 41.

<sup>53</sup> Raporti i Dytë, para. 42-43.

<sup>54</sup> Vendimi Kornizë, para. 42.

<sup>55</sup> Raporti i Dytë, para. 38.

<sup>56</sup> Raporti i Dytë, para. 38.

vendimi, për të shmangur kështu çdo vonesë të panevojshme në pjesëmarrjen e VPP-ve. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron Administratoren që, deri të premtën, 7 maj 2021, të caktojë mbrojtësin e viktimave me qëllim përfaqësimin e përbashkët të Grupit 1. Preferencat e shprehura nga viktimat 05/05 dhe 09/05 për përfaqësim nga një mbrojtës ndërkombëtar do të shqyrtohen me vëmendjen e duhur.

#### E. PJESËMARRJA NË PROCEDURËN PARAPRAKE

50. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se, në pajtim me nenin 22 të Ligjit dhe rregullën 114 të Rregullores, VPP-të ushtrojnë të drejtat e tyre përmes mbrojtësit të viktimave dhe marrin pjesë në procedurën paraprake në përputhje me modalitetet e përshkruara në vijim. Duhet theksuar se modalitet e parashtruara në vijim në çdo kohë janë brenda kompetencës së Gjykatësit të Procedurës Paraprake. Të drejtat për pjesëmarrje mund të ndryshohen në raste të veçanta, nëse nuk cenohen interesat personale të VPP-ve ose nëse diktohet nga arsye të tjera.

51. Së pari, në pajtim me rregullën 114(3) të Rregullores, mbrojtësi i viktimave ka qasje në të gjithë dosjen e çështjes, përfshirë të gjitha parashtrimet e protokolluara, transkriptet dhe materialet provuese, publike dhe konfidenciale, me përjashtim të materialeve *ex parte* të dosjes së çështjes. Po kështu, mbrojtësi i viktimave informohet për të gjitha materialet e shpërndara që i përkasin dosjes së çështjes, ku përfshihen të gjitha parashtrimet e protokolluara, transkriptet dhe nxjerrjet e materialeve provuese, publike dhe konfidenciale, me përjashtim të materialeve të shpërndara *ex parte* të dosjes së çështjes. Mbrojtësi i viktimave nuk ka qasje dhe nuk informohet për materiale rreptësisht konfidenciale, ku përfshihen parashtrime të protokolluara, transkripte apo materiale provuese, nëse nuk përcaktohet shprehimisht ndryshe. Mbrojtësi i viktimave i informon rregullisht VPP-të për zhvillimet përkatëse në çështjen gjyqësore, në një mënyrë që nuk zbulon informacione jopublike.

52. Së dyti, në pajtim me nenin 22(6) të Ligjit dhe rregullën 114(2) të Rregullores dhe për të garantuar përfaqësimin e duhur të interesave personale të VPP-ve në çdo kohë, mbrojtësi i viktimave mund të jetë i pranishëm në të gjitha seancat e procedurës paraprake, me përjashtim të seancave *ex parte*.

53. Së treti, në pajtim me nenin 22(6) të Ligjit dhe rregullën 114(4) të Rregullores, mbrojtësi i viktimave ka të drejtën të bëjë parashtrime me gojë dhe me shkrim. Për të siguruar një modalitet të pjesëmarrjes pa pengesa dhe efikas, mbrojtësit të viktimave nuk i kërkohet që të kërkojë paraprakisht leje për të bërë parashtrime me gojë dhe me shkrim, por i kërkohet që në parashtrimin përkatës të bëjë të ditur se cili interes personal konkretisht preket.

## V. VENDIM

54. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a. **MIRATON** kërkesat e viktimave 05/05, 06/05, 07/05, 08/05, dhe 09/05 dhe i pranon këta parashtrues kërkesë në proces si VPP;
- b. **VENDOS** që viktimat 05/05, 06/05, 07/05, 08/05, dhe 09/05 të përfaqësohen si Grupi 1;
- c. **URDHËRON** Administratoren që deri të premtën, 7 maj 2021, të caktojë mbrojtësin e viktimave me qëllim përfaqësimin e përbashkët të Grupit 1;
- d. **VENDOS** që mbrojtësi i viktimave i caktuar si më lart:
  - i. të ketë qasje në të gjithë dosjen e çështjes, përfshirë të gjitha parashtrimet e protokolluara, transkriptet dhe materialet provuese, publike dhe konfidenciale, me përjashtim të materialeve *ex parte* të dosjes së çështjes;

- ii. të njoftohet për të gjitha materialet e shpërndara në dosjen e çështjes, përfshirë të gjitha parashtrimet e protokolluara, transkriptet, nxjerrjet e materialeve provuese, publike dhe konfidenciale, me përjashtim të materialeve të shpërndara *ex parte* të dosjes së çështjes;
  - iii. të mos ketë qasje e as të njoftohet për materiale rreptësisht konfidenciale, përfshirë parashtrime të protokolluara, transkripte apo materiale provuese, nëse nuk përcaktohet shprehimisht ndryshe;
  - iv. të informojë rregullisht VPP-të për zhvillimet përkatëse në çështjen gjyqësore, në një mënyrë që nuk zbulon informacione jopublike;
  - v. të jetë i pranishëm në të gjitha seancat e procedurës paraprake, me përjashtim të seancave *ex parte*; dhe
  - vi. të lejohet të bëjë parashtrime me gojë dhe me shkrim sa herë që preken interesat personale të VPP-ve, sikurse përcaktohet në paragrafin 53;
- e. **URDHËRON** që masa mbrojtëse e anonimitetit sipas rregullës 80(4)(e)(i) të Rregullores t’u miratohet viktimave 05/05, 06/05, 07/05, 08/05, dhe 09/05;
  - f. **URDHËRON** që emrat dhe të dhënat identifikuese të viktimave 05/05, 06/05, 07/05, 08/05, dhe 09/05 të mos u bëhen të ditura palëve dhe publikut; dhe
  - g. **URDHËRON** ruajtjen e klasifikimit rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* për të gjitha përmbledhjet e kërkesave, formularët e kërkesave dhe dokumentacionin mbështetës.

/nënshkrimi/

**Gjykatës Nikola Giju**  
**Gjykatës i Procedurës Paraprake**

E premte, 30 prill 2021  
Në Hagë, Holandë.